



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË - KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për Aktivitete jashtëshkollore me nr. 02/2016 të datës 12.01.2016; Gjymnazi "Hivzi Sulejmani" në Fushë - Kosovë, shpallë:

Ftesë për ofertë: Realizimi i ekskursionit për nxënësit maturant (klasa e XII-të)

Ftohen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë "Agjenci udhëtimi" apo "Opertorët turistik", që të marrin pjesë në realizimin e ekskursionit për 186 maturantët e Gjymnazit "HIVZI SULEJMANI" në Fushë - Kosovë

- Në ofertë të parashihet çmimi i cili përfshinë transportin, akomodimin në hotel, ushqimin cilësor e kalorik, sigurinë fizike të nxënësve, shërbimin 24 orësh mjekësor dhe shpenzimet e tjera që paraqiten me rastin e vizitave në vende muzeale, kala (Kështjella), qytete historike,
- Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) pansione të plota, në ditën e pestë (5) kthimi për në shtëpi,
- Realizimi i ekskursionit mundësisht të bëhet brenda afatit optimal, e preferuar java e parë e tetorit 2025.

"Agjencionet e udhëtimit" në ofertën e tyre duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Agjencioni të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit,
2. Autobuset të jenë komfort, me klimë, WFI dhe elemente tjera,
3. Agjencioni të ketë kontrollimin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike (Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për të gjithë autobusët që do të përdoren në bartjen e nxënësve maturant),
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës (ekskursionit) dhe dëshmi të shërbimit teknik,
5. Agjencioni duhet të ketë dëshmitë (fotokopje) librezat e autobusave,
6. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferave) të autobusave,
7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje dhe shërbimin mjekësor për të gjithë nxënësit, që nga nisja, kohëzgjatja dhe mbyllja e ekskursionit, pastaj certifikatën dhe kontratën e punës së mjekut të angazhuar,
8. Rezervimi i hotelit me dëshmi origjinale e të vulosur dhe në bashkëpunim me hotelin të ofrojë siguri 24 orësh për nxënësit dhe personelin përcjellës,
9. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit).

Afati i paraqitjes së ofertave me të gjithë dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga data e publikimit në faqen zyrtare (Web) të Komunës së Fushë - Kosovës.

Dorëzimi i ofertave: Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur deri më datën **25 shtator 2025** në adresën: Gjymnazi "Hivzi Sulejmani" në Fushë-Kosovë, rruga "Aziz Zhitivoda" nr.23. Hapja e ofertave bëhet më datën **25 shtator 2025** (e enjte) nga ora 14:00 nga Komisioni pa praninë e ofertuesve. Agjencioni apo ofertuesi i përzgjedhur do të njoftohet përmes mjeteve të komunikimit nga zyrtarët e shkollës.

Fushë - Kosovë, më 17.09.2025



Drejtori i shkollës: Msc. Amir Pillana